VENDIM
Nr. 465, datë 18.7.2012

PËR INTEGRIMIN GJINOR NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 2 e 13, pika 2, shkronja "b" të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në kërkesat buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, brenda një ose dy programeve buxhetore, të përcaktojnë minimalisht një objektiv të politikës gjinore për të zbatuar integrimin gjinor në buxhetim.

2. Duke filluar nga viti 2013, të përfshihen në procesin e buxhetimit gjinor të gjitha ministritë e linjës.

3. Ministritë të përcaktojnë tregues të përshtatshëm dhe të matshëm gjinorë për objektivat dhe produktet e secilit program, për të cilin do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim.

4. Grantet që do të alokohen nga fondi për zhvillimin e rajoneve të marrin në konsideratë kritere që ndikojnë pozitivisht në barazinë gjinore.

5. Përcaktimi i programeve buxhetore, për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim, të bëhet mbështetur në objektivat e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 2011-2015.

6. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të këshillojë të gjitha ministritë për të përcaktuar programet buxhetore për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor.

7. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave më të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha